



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 255/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Blerim Dina– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Goran Milenković-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "EnGrup" SH.P.K.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE N.N."Prishtina"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Ndërtimi i Qendrës për Mjekësi Familjare ne Fushë Kosovë", me numër të prokurimit: 612-19-2090-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Fushë Kosovë, më datën 20.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "EnGrup" SH.P.K. -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Ndërtimi i Qendrës për Mjekësi Familjare ne Fushë Kosovë", me numër të prokurimit: 612-19-2090-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Fushë Kosovë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Ndërtimi i Qendrës për Mjekësi Familjare ne Fushë Kosovë", me numër të prokurimit: 612-19-2090-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Fushë Kosovë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "EnGrup" SH.P.K. -Prishtinë,aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:12.04.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt:07.05.2019

Njoftimi me letër standarde për tenderues të eliminuar dt: 17.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim me dt:22.05.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 24.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "EnGrup" SH.P.K. -Prishtinë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me28.05.2019me nr. 255/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE N.N."Prishtina"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Qendrës për Mjekësi Familjare në Fushë Kosovë", me numër të prokurimit: 612-19-2090-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Fushë Kosovë,duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin1,7,59, 60dhe 69të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtueseprofesionaletëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja Shqyrtuese në raportin e dt:12.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:Lidhur me pretendimin e OE ankues,se OE i rekomanduar për kontratë N.N " PRISHTINA " nuk i plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pika 9.1, siç janë kërkuar në dosje të tenderit, kompania në fjalë ka një listë të kontratave në të cilën janë disa kontrata me te vjetra se tri vite, disa kontrata të pa përfunduara, që nuk kanë pranime teknike apo referenca dhe nuk mundën të llogariten si të përfunduara.

Kompania fituese N.N “ PRISHTINA ” vlera e të gjitha kontratave që ka paraqitur në dosje të tenderit, në listën e paraqitur është 411,596.66€, edhe ne këto kontrata janë disa pune të kryera në vitin 2015, Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e AK kundërshtojnë tenderin dhe njoftimin për kontratë ka qenë:

Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratë të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej min. 510.000.00 €.

Ekspertja shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka të bashkangjitur listën e kontratave të realizuara dhe disa raport/referencë po ashtu me datën 13.05.2019 AK Komuna Fushë Kosovë duke u bazuar në nenin 69 të LPP-së, dhe sqarimet në nenin 39.8 të RRUOPP-se përmes platformës elektronike ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë. Në sistemin elektronik të dokumentet tjera me dt. 15.05.2019 janë ngarkuar disa raporte të pranimit dhe një deklaratë nga OE N.N Prishtina ku ka plotësuar dokumentacionin (ka sjell dëshmi referencë/raporte) duke u bazuar në nenin 69 të LPP-se dhe në sqarimet e RRUOPP-se nën 39.8 ku thotë :

39.8 Mungon referencë /certifikatë e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara. Mund të kërkojnë informata sqaruese.

Prandaj duke i mbledhur të gjitha vlerat e prezantuara në ofertën e dorëzuar dhe në dokumentin e ngarkuar në platformën E- prokurim pa i llogaritur vlerat e kontratave të viteve të mëshme dhe ato të cilat nuk janë dëshmuar me referencë/raporte, vlera e kontratave të realizuara dhe të dëshmuara me raport/referencë arrijnë vlerën prej 607,081.69, që plotësojnë kriterin e vendosur nga ana e AK-se.

Duke u bazuar në sqarimet më lart AK ka respektuar LPP- në dhe RRUOPP-në. Nga ajo që u tha më lart eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtuesi propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pa bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), dhe të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues KK Fushë Kosovë.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 14.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 12.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroi: Ne qëndrojmë në tërësi pran pretendimet ankimore të parashtruar në ankesën me datën 28.05.2019 dhe njëkohësisht ju sqarojmë se OE i Rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT-së konkretisht nuk ka ofruar dëshmi në listën e kontratave të prezantuara se ka përfunduar kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë minimum 510.000 Euro. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e kontratave mirëpo që në atë listë nuk figuron që 3 vitet e fundit ka arritur vlerën e lartcukur të kontratave të përfunduara. Këtë fakt e ka pranuar edhe vërtetuar edhe vet Autoriteti Kontraktues ku në raportin e vlerësimit i cili raport është i nënshkruar edhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit është shënuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk e arrin vlerën e kontratave mbi 510.000 euro. Por Autoriteti Kontraktues me pastaj i ka marrë parasysh disa situacione dhe raporte të punës si të vlefshme dhe e ka rekomanduar për kontratë OE N.N. "PRISHTINA. Konform nenit 39.8 të RrUOPP-së ku parashihet se nëse lista e kontratave nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se kërkuar atëherë duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar indokim apo sqarime shtesë. Ne nuk pajtohemi gjithashtu me mendimin dhe rekomandimin e ekspertës shqyrtuese për shkak se nuk është cukur kjo dispozite e këtij udhëzuesi operativ mirëpo ekspertja shqyrtues i është referuar një dispozite tjetër ku flet për mungesën e referencave dhe certifikatat e pranimeve teknike e ku në këtë rast lejohen të kërkojnë sqarime shtesë. Këtu faktikisht mendojmë që është bërë një ngatërrim i çështjes për shkak që nuk kemi të bëjmë me mungesë të referencave dhe procesverbaleve teknike por kemi të bëjmë me mos përmbushje të kërkesës në lidhje me vlerën e kërkuar tek lista e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit. Kjo mund të vërtetohet edhe nga paneli shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Prebreza deklaroi: Jemi munduar të vlerësojmë drejt. Qëndrojmë prapa vendimit të Autoriteti Kontraktues dhe çdo sqarim shtesë që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe sqarime nga OE janë në sistemin E-prokurim, në si Autoriteti Kontraktues mendojmë se nuk kemi bërë asnjë shkelje të dispozitave të LPP-së.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja shqyrtues znj. Beka deklaroi: Është e vërtetë se ka kontrata të viteve të mëshme dhe në dorëzimin e ofertës kanë munguar disa raporte të pranimi siç ka qenë kërkesa e Autoriteti Kontraktues mirëpo duke u bazuar në nenin 39.8 të RrUOPP-së nëse mungojnë referencat e

pranimi e lista e kontratave te pranuar mund të kërkohen informata sqaruese. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtese dhe ne sistemin e E-prokurimit me datë: 15.05.2019 janë ngarkuar raportet e pranimi referenca dhe raporte, dhe duke i mbledhur listën e kontratave të dorëzuara OE i rekomanduar e plotëson këtë kriter. Qëndroje prapa raportit te dhen ne ekspertizë me datë: 12.05.2019

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovohet ankesa e jonë si e bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe të zbatohen të gjitha dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesjae AK-së deklaroj: Kërkojmë të refuzohet ankesa e OE ankuese si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë N.N “ PRISHTINA ” nuk i plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pika 9.1, siç janë kërkuar në dosje të tenderit, kompania në fjalë ka një listë të kontratave në të cilën janë disa kontrata me te vjetra se tri vite, disa kontrata të pa përfunduara, që nuk kanë pranime teknike apo referenca dhe nuk munden të llogariten si të përfunduara. Kompania fituese N.N “ PRISHTINA ” vlera e të gjitha kontratave që ka paraqitur në dosje të tenderit, në listën e paraqitur është 411,596.66€, edhe ne këto kontrata janë disa pune te kryera ne vitin 2015, duke u bazuar ne kërkesat e AK ku ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë është kërkuar :

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se kërkesa e AK-se ka qen që Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë në vlere prej min. 510.000.00 €. OE i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tij ka te bashkangjitur listën e kontratave të realizuara dhe disa raport/referencë po ashtu me datën 13.05.2019 AK Komuna Fushë Kosovë duke u bazuar ne nenin 69 të LPP-së, dhe sqarimet ne nenin 39.8 te RRUOOP-se përmes platformës elektronike ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë. Ne sistemin elektronik te dokumentet tjera me dt. 15.05.2019 janë ngarkuar disa raporte te pranimi dhe një deklaratë nga OE N.N Prishtina ku ka plotësuar dokumentacionin (ka sjell dëshmi referenca/raporte) duke u bazuar ne nenin 69 te LPP-se dhe ne sqarimet e RRUOPP-se neni 39.8 ku thotë :

39.8 Mungon referenca /certifikata e pranimi nga lista e kontratave te prezantuara. Mund të kërkohen informata sqaruese.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se duke i mbledhur të gjitha vlerat e prezantuara në ofertën e dorëzuar dhe në dokumentin e ngarkuar në platformën E- prokurim pa i llogaritur vlerat e kontratave të viteve të me hershme dhe ato të cilat nuk janë dëshmuar me referenca/raporte, vërtetohet se vlera e kontratave të realizuara dhe të dëshmuara me raport/referencë arrin vlerën prej 607,081.69, pra dëshmitë e ofruara nga OE ne fjale plotësojnë kriterin e vendosur nga ana e AK-së.

Andaj duke u bazuar ne sqarimet me lart AK ka respektuar LPP- në dhe RRUOPP-në. Nga ajo qe u tha me lart paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave ne përgjithësi i është përmbajtur dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim Dina



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Fushë Kosovë,
- 1x1 OE–"EnGrup"SH.P.K. - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.